



Duke u bazuar në nenin 43, 45 dhe 47 të Ligjit për Vetëqeverisje lokale, Nr.03/L-040, nenin 47 të Statutit të Komunës së Klinës Nr. 01-110-1232/2010. Nenin 5 të Udhëzimit Administrativ MAPL Nr.02-2015 për mbajtjen e mbledhjeve të kuvendit të komunës si dhe nenit 4 të Rregullores për Punë të Kuvendit dhe Komiteteve të Komunës, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës bën këtë:

### FTESË


Ftohën të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës së Klinës dhe të interesuarit e tjerë që të marrin pjesë në seancën e V-të të rregullt të punës së kuvendit për vitin 2023. Seanca mbahet më 26.05.2023 (e Premte), në sallën e Kuvendit të Komunës së Klinës dhe fillon në orën 10:00.

Lidhur me çështjen e mospjesëmarrjes në seancë, t'i referoheni dispozitës së nenit 39 të LVL-së. Për këtë seancë propozohet ky:

### RENDI I DITËS:

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Rekomandimeve të Komitetit për Politik dhe Financa,
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të DKA-së për ndarjen e bursave për student dhe formimin e komisionit për ndarjen e tyre (ref. nga DKA)
5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të DUMM për iniciimin e procedurave për ndryshimin dhe plotësimin e Hartës Zonale të Komunës së Klinës (ref. nga DUMM)
6. Pyetje dhe përgjigjeje.

01Nr. 06-15795 2023  
Klinë, me 12.05 2023



Kryesuesi,  
Fadi Gashi



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS  
MUNICIPALITY OF KLINA  
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

*Na osnovi člana 43, 45 i 47 Zakona 03/L-040 o Lokalnu Samoupravu, člana 47 Statuta Opštine Klina 01-110-1232/2010, člana 5 AU MLS broj 02-2015 o sastancima skupštine opštine i člana 4 pravilnika za rad skupštine i opštinskih komiteta, predsedavajući Skupštine Opštine vrsi sledeće:*

### OBAVEŠTENJE

Pozivaju se članovi Skupštine Opštine Klina i ostali zainteresovani da prisustvuju V-m redovnom sastanku skupštine za 2023 godinu.

Sastanak se održava 26.05.2023 (Petak), u Sali Skupštine Opštine od 10:00.

U slučaju neprisustvavanja sastanku, molimo vas da se oslonite odredbi člana 39 ZLS.

Predloženi:

### DNEVNI RED:

1. Obrazloženje izostanaka,
2. Razmatranje i usvajanje zapisnika sa prethodnog sastanka,
3. Razmatranje i usvajanje preporuka Političkog i Finansijskog komiteta,
4. Razmatranje i davanje saglasnosti na predlog OO za dodelu stipendija studentima i formiranje komisije za njihovu dodelu (ref. OO)
5. Razmatranje i usvajanje predloga OUZS-e za pokretanje procedure za izmenu i dopunu Zonske karte opštine Klina (ref. OUZS)
6. Pitanja i odgovori

01Br. 06-15795 2023  
Klina, 12.05 2023



Predsedavajući,  
Fadil Gashi



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS  
MUNICIPALITY OF KLINA  
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

06 Nr. Prot. 351-16006 /2023

dt. 15.05.2023

NGA: Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit z.Enver Berisha



Lënda: Arsyetimi i DUMM lidhur me kërkesë për iniciimin e procedurës për plotësim dhe ndryshim të Hartës Zonale të komunës së Klinës

Ju njoftojmë se DUMM ka parashtruar kërkesë sipas nenit 10,11 të LIGJI NR. 04/L-174 PËR PLANIFIKIMIN HAPËSINOR pastaj UA-Nr: 24/2015, mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e HZK, tek Kuvendi Komunal për iniciimin e procedurës për plotësim dhe ndryshim të HZK, qellim dhe arsyeja e plotësim ndryshimit të HZK ka ardhur pas identifikimit të disa projekteve zhvillimore për komunën e Klinës si dhe kërkesave të personave fizik dhe juridik si dhe komunitetit me qellim realizimit të projekteve të ndryshe si: Projekte me karakter zhvillimore që kanë për qellim promovimin dhe investimin në energjisë së ripërtitshme, Projekte edukative, qerdhe, objekte të kulturës, arsimit, projekteve për shërbime për komunitetin si përcaktimi i lokacioneve të varrezave neper disa lokalitete, Objekteve fetare nëpër fshatra, projekte për ndërtimin e objekteve për shërbime sociale "shtëpi të pleqve" si dhe projekteve të tjera që dalin nga strategjia zhvillimore komunale, po ashtu projekteve të parapara nga ana e kuvendit komunal si dhe projekte tjera që mund të dalin gjatë procedurës së shqyrtimit publik.

Qëllimi i këtij propozimi për ndryshim dhe plotësim të ZHK, ka a si synim realizimin e projekteve jetike zhvillimore, si dhe ofrimi o shërbimeve sa më adekuate të komunitetit, dhe hapjes së mundësi se investimeve strategjike duke vlerësuar komunën tone si zone me potencial të madhe për investime në energjinë e ripërtitshme.

Me respekt.

Klinë 15.05.2023

AVOKAT  
Ardian Deskaj  
Tel:+38344633622  
Rr.Abedin Rexha Klinë

KOMUNËS SË KLINËS

KRYESUESIT TË KUVENDIT KOMUNAL TË KLINËS

KOMISIONIT PËR EMËRTIM TË RRUGËVE

Nga: banoret e fshatit Shtupel, lagja Bakaja,

Tel: 045 524 481

02.05.2023

06-221-14574/23

### Kërkesë për Ndryshim të emrit të Rrugës

Në fshatin Shtupel, Komuna e Klinës, në lagjen, Bakaja, aktualisht është një rrugë me emrin "Fadil Zhabota".

Kjo rrugë është shumë e gjatë e cila fillon nga rruga Kryesorë Shtupel dhe përfundon Jashanice. Fshati Shtupel dhe lagja Bakaja ka shumë persona që kanë sakrifikuar për komb, dhe shumë martir.

Me qënë se kjo rrugë është shumë e gjatë, dhe pas që kjo rrugë në Lagjen Bakaja merr kthese, Banoret e kësaj lagje kërkojnë që pjesa e kësaj rrugë të ndryshohet dhe të bëhet rruga "Bajram (Bali) Arifaj".

Bajram Arifaj ka qënë i fshatit Shtupel, ka lindur ne vitin 21.02.1929, është vrare nga forcat serbe, me datën 29.03.1999, i cili ka punuar në Pejë dhe ka kontribuar në luftën e Kosovës 1997-1999, duke strehuar ushtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, për çka edhe është vrare në vitin 1999.

Klinë

Me datën 02.05.2023

Parashtruesi i kërkesës.

Kryetari i fshati shtupel Isni Arifaj \_\_\_\_\_

Isa Arifaj Djali i Bajram Arifaj \_\_\_\_\_

Enver Arifaj banor \_\_\_\_\_



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS  
MUNICIPALITY OF KLINA  
OPŠTINA KLINA



[www.komuna-klina.org](http://www.komuna-klina.org)

DREJTORIA E ARSIMIT

Nr. 154-1464 2023

Datë: 03.05 2023

Për: Kuvendin e Komunës – Kryesuesin z. Fadil Gashi

Nga: Dr.sc. Qemajl Sejdiqja-Drejtor i DKA-së

Përmes: Kryetarit të Komunës, z. Zenun Elezaj

Lënda: Kërkesë për marrje të vendimit për ndarje të bursave për studentë të Komunës së Klinës për vitin akademik 2022/2023 dhe për formimin e komisionit për ndarjen e bursave

Kërkojmë nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Klinës, z. Fadil Gashi, që për seancën e majit 2023 të futë në rend dite kërkesën e DKA-së për marrje të vendimit për ndarje të bursave për studentë të Komunës së Klinës të vitit akademik 2022/2023 dhe për emërimin e komisionit përkatës.

Kërkesën e bëjmë duke u mbështetur në Rregulloren për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Klinës numër 01 nr.06-8132/20 të datës 04.03.2020.

Komisioni që do të emërohet do të jetë kompetent për ndarjen e 60 bursave në vlerë prej 50 euro për çdo muaj për studentë të Komunës së Klinës, sipas kriterëve të Rregullores së cekur më lart dhe konkursit që do të shpallet nga DKA-ja.

Faleminderit për ndihmesën dhe bashkëpunimin tuaj.



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS  
MUNICIPALITY OF KLINA  
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

NGA: Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit z.Enver Beqisha

PËR: Komitetin për Politik dhe Financa në Klinë

Lënda: Kërkesë për inicimin e procedurës për plotësim dhe ndryshim të Hartës Zonale të komunës së Klinës

Ju njoftojmë se pas një analize dhe pas konsultave edhe me ekspert lidhur plotësim ndryshimin e HZK, DUMM propozon që të merret vendim lidhur me inicimin për plotësim dhe ndryshim të HZK komuna e Klinës me të vetmin qëllim që të përcaktohen disa prioritete zhvillimore që ka kjo Komune.

Duke shpresuar që në afat ligjor do ndërmerrni veprime të duhura rreth procedimit dhe miratimit të vendimit për plotësim dhe ndryshim të HZK,

Jemi në dispozicion të gjitha organeve kompetente për sqarimet përkatëse, të cilat do të ndihmonin lidhur me këtë qështje.

01-9431-14902/23

Klinë, më 04.05 /2023

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS  
MUNICIPALITY OF KLINA  
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Kuvendi i Komunës Klinë  
Komiteti për Politikë dhe Financa  
01Nr 06-15786 /23  
Klinë: 12.05.2023

PËR: Kuvendin e Komunës Klinë

Nga: Komiteti për Politikë dhe Financa

Kryesuesi i Komitetit: Fadil Gashi



REKOMANDIMET e Komitetit për Politikë dhe Financa të datës 10.05.2023.

Komiteti për Politikë dhe Financa, në seancën V-të të rregullt për vitin 2023, shqyrtoi dhe miratoi për shqyrtim në kuvend këto pika:

**Pika 1. Shqyrtimi i propozimit të DKA-së për ndarjen e bursave për studentë dhe formimin e komisionit për ndarjen e tyre.**

-Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kryesuesi theksoi se: Propozim-vendimi i DKA-së lidhur me ndarjen e bursave është që të merret vendim në kuvend, që të ndahen gjithsej 60 bursa për studentët e dalluar të Komunës së Klinës në vlerë prej 50 euro në muaj për vitin kalendarik 2022-2023 si dhe të formohet komisioni për ndarjen e këtyre bursave.

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të propozim-vendimit për ndarjen e bursave për studentë dhe formimin e komisionit për ndarjen e tyre, rekomandoi që të rritet vlera e bursave nga 50 euro në 70 euro në muaj, gjithashtu rekomandoi që kjo pikë të kalojë për shqyrtim dhe miratim në kuvend.

**Pika 2. Shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politikë dhe Financa për muajin prill-maj 2023.**

**Kërkesë:**

Nga banorët e fshatit Shtupel të cilët theksojnë: Në fshatin Shtupel, Komuna e Klinës, në lagjen "Bakaja", aktualisht është një rrugë me emrin "Fadil Zhabota".

Kjo rrugë është shumë e gjatë, duke filluar nga rruga kryesore Shtupel dhe përfundon në fshatin Jashanicë.

Fshati Shtupel dhe lagja "Bakaja" ka shumë persona që kanë sakrifikuar për komb, dhe shumë martirë.

Meqenëse kjo rrugë është shumë e gjatë dhe, pasi që kjo rrugë në lagjen "Bakaja" merr kthesë, banorët e kësaj lagje kërkojnë që pjesa e kësaj rruge të ndryshojë emrin dhe të emërohet rruga "Bajram (Bali) Arifaj".

Bajram Arifaj ka qenë banor i fshatit Shtupel, ka lindur me datë: 21.02.1929 dhe është vrarë nga forcat serbe, me datën 29.03.1999, i ndjeri ka punuar në Pejë dhe ka kontribuar në luftën e Kosovës gjatë viteve 1997-1999, duke strehuar ushtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, për çka edhe është vrarë në vitin 1999.

**Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të kërkesës për ndryshimin e emrit të rrugës, rekomandoi që kërkesa e banorëve të fshatit Shtupel, të dërgohet për shqyrtim tek komisioni për emërimin dhe riemërimin e rrugëve dhe vendeve tjera publike në Komunën e Klinës.**